

# NDËRMJET DISTANCËS DHE MUNDËSISË

Qëndrimet e të Rinjve Serb ndaj  
Punësimit në Institucionet e Kosovës

QERSHOR 2025

---

Ky raport shqyrton arsyet themelore të mungesës së interesimit të të rinjve serbë në Kosovë për t'u punësuar në institucionet e Kosovës, duke zbuluar një ndërlidhje komplekse të tensioneve politike, qëndrimeve të komunitetit, faktorëve ekonomikë dhe pengesave institucionale.

---



# Hyrje

Çështja e punësimit adekuat të pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë në institucionet e administratës publike në Kosovë është njëra ndër çështjet më të gjata dhe më të ndjeshme kur bëhet fjalë për realizimin e të drejtave të komuniteteve dhe ndërtimin e besimit. Për shkak të rëndësisë që kjo çështje ka për pozitën e përgjithshme të komuniteteve joshumicë në Kosovë, ajo është trajtuar në mënyrë të detajuar në raportin “Korniza ligjore për mbrojtjen e komuniteteve joshumicë në Kosovë: Analizë gjithëpërfshirëse e dispozitave kushtetuese, ligjore dhe nënligjore”. Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “Përmirësimi i përfshirjes dhe avancimi i të drejtave të komuniteteve joshumicë përmes zhvillimit të legjislationit dhe politikave në Kosovë”, i cili zbatohet nga OJQ ACDC me mbështetjen e IOM. Qëllimi i raportit është të ofrojë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të mekanizmave ekzistues për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve joshumicë në Kosovë.

Si vazhdim i kësaj nisme, në shkurt të vitit 2025 është organizuar një punëtori treditore që ka mbledhur përfaqësues të institucioneve kosovare dhe të organizatave të shoqërisë civile. Gjatë punëtorisë, veçanërisht është veçuar çështja e punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë në institucionet kosovare. Edhe pse korniza ligjore parasheh garanci të qarta, përfshirë detyrimin që së paku 10% e të punësuarve në institucionet qendrore të jenë nga komunitetet joshumicë, ndërsa në nivel lokal punësimi duhet të reflektojë strukturën demografike të popullsisë, praktika tregon se minimumi i përcaktuar rrallëherë arrihet.

Pjesëmarrësit e punëtorisë kanë theksuar pengesat në përmbushjen e obligimeve ligjore sa i përket punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë – nga mungesa e vullnetit politik deri te praktikat institucionale joadekuate. Përveç dështimeve në funksionimin e institucioneve, është vërejtur edhe një sfidë tjetër që shpeshherë injorohet. Bëhet fjalë për mungesën gjithnjë e më të theksuar të interesimit nga ana e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë, veçanërisht të të rinjve nga komuniteti serb, për të aplikuar për punë në institucionet kosovare. Për këtë arsye, është shfaqur nevoja që të hulumtohen më tej arsyet për të cilat të rinjtë serb rrallëherë aplikojnë për vende pune në institucionet kosovare. Ideja ka qenë që të fitohet një kuptim më i thellë mbi perceptimet, motivimet, dilemat dhe rezervat që formësojnë qëndrimet e të rinjve serb ndaj mundësisë së punësimit në institucionet kosovare.

Për të pasur një kuptim më të thelluar mbi arsyet e interesimit gjithnjë e më të vogël të të rinjve serb për punësim në institucionet kosovare, është iniciuar një hulumtim shtesë cilësor me qëllim të shqyrtimit të faktorëve kyç shoqërorë, politikë dhe institucional që dekurajojnë të rinjtë serb të kërkojnë punë në institucionet e Kosovës.

Hulumtimi është realizuar gjatë pranverës së vitit 2025 me metodën e intervistave gjysmë të strukturuar. Në kuadër të hulumtimit janë organizuar dy fokus grupe dhe janë zhvilluar gjashtë intervista individuale. Mostra ka përfshirë gjithsej pesëmbëdhjetë të rinj nga komuniteti serb nga pjesë të ndryshme të Kosovës – si nga vendbanimet serbe në jug të lbrit, ashtu edhe nga veriu i Kosovës. Një fokus grup është mbajtur në Graçanicë, me katër pjesëmarrës nga vendbanime në jug të lbrit, ndërsa grupi tjetër është mbajtur në veri, me pesë pjesëmarrës nga veriu i Kosovës. Gjashtë intervista të thelluara kanë mundësuar një pasqyrë më të detajuar mbi qëndrimet individuale dhe arsyet që ndikojnë në qëndrimin e të rinjve ndaj punësimit në institucionet kosovare.

Mostra përfshinë të anketuar nga gjithsej nëntë komuna të Kosovës. Nga komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës janë përfshirë Mitrovica e Veriut, Zubin Potoku dhe Leposaviqi, ndërsa nga jugu janë përfshirë Graçanica, Ranillugu dhe Shtërpca. Përveç kësaj, mostra përfshinë edhe tri komuna në të cilat serbët përbëjnë pakicë: Vushtrria (vendbanimi Prilluzhë), Kamenica (vendbanimi Ropotovë e Madhe) dhe Peja (vendbanimi Gorazhdec).

Qëllimi i hulumtimit ka qenë që, përmes njohurive të drejtpërdrejta, përceptimeve dhe përvojave të përditshme të të anketuarve, të ndriçohet kompleksi i rrethanave që formësojnë qëndrimet, rezervat dhe pritjet e tyre në lidhje me punën në institucionet e Kosovës. Përveç motiveve individuale, hulumtimi ka për qëllim gjithashtu identifikimin e modeleve më të gjera brenda komunitetit që kontribuojnë në reagimin e ulët të të rinjve serb ndaj konkurseve për punë në kuadër të sistemit kosovar.

Gjetjet e hulumtimit janë paraqitur përmes një analize tematike që përfshinë modelet dominante, rezervat dhe dilemat që formësojnë qëndrimet e të rinjve serb ndaj punësimit në institucionet kosovare. Raporti fillimisht paraqet një mospërfillje të përgjithshme dhe distancë ndaj këtyre institucioneve, më pas shqyrton kushtet nën të cilat individët megjithatë do të merrnin parasysh mundësinë e punësimit, me theks të veçantë në kontekstin lokal, tensionet politike, pengesat procedurale, si dhe ndikimin e mjedisit shoqëror dhe pritjeve të komunitetit. Pjesa përfundimtare sjell një sintezë të gjetjeve dhe rekomandime për nisma të ardhshme.





## Gjetjet e hulumtimit

---

Analiza e deklaratave të të rinjve të intervistuar nga komuniteti serb nga pjesë të ndryshme të Kosovës zbulon një pasqyrë komplekse dhe shumëdimensionale të qëndrimeve ndaj punësimit në institucionet kosovare. Në vend të një qëndrimi të unifikuar, vërehen ndërthurje të përvojave të përbashkëta, rrethanave specifike lokale dhe mendimeve individuale.

Qëndrimi që të anketuarit kanë ndaj institucioneve të Kosovës nuk është homogjen dhe i pandryshueshëm, por varet nga rrethanat politike aktuale, shkalla e besimit në institucione, si dhe mendimet ekzistenciale të përditshme. Nga bisedat bëhet e qartë se vendimi për të aplikuar për punë në institucionet kosovare nuk është vetëm çështje individuale dhe profesionale, por lidhet me një kontekst më të gjerë politik dhe me situatën në komunitet.

Përgjigjet e të anketuarve, megjithëse të ndryshme në disa aspekte, tregojnë disa modele dhe determinantë kyç që formësojnë vendimet e tyre lidhur me pyetjen nëse dhe në çfarë kushtesh do të aplikonin për një vend pune në institucionet e Kosovës.

# Mospërfillje e përgjithshme ndaj institucioneve kosovare

Gjetja kryesore e hulumtimit është se shumica dërrmuese e të anketuarve shfaqin mospërfillje ndaj punës në institucionet kosovare. Disa kanë theksuar se asnjëherë nuk kanë menduar për mundësinë e të punuarit në këto institucione, përkatësisht se kjo asnjëherë nuk u ka *“shkuar në mendje”*. Madje edhe të anketuarit që aktualisht janë të papunë deklarojnë se nuk e konsiderojnë këtë si një opcion të mundshëm. Të pyetur për arsyet e kësaj mospërfilljeje, të anketuarit përgjithësisht nuk kanë pasur përgjigje të gatshme, çka dëshmon për një përkushtim të ulët ndaj kësaj teme. Ata theksojnë se *“nuk e shohin veten”* si pjesë e atij sistemi, se kjo mundësi u është *“e huaj”* dhe se nuk mendojnë fare për të. Përveç kësaj, si disa nga arsyet konkrete përmenden pagat e ulëta, lidhja e institucioneve me politikën dhe mungesa e perspektivës për avancim.

Në përputhje me mungesën e interesimit për punë në institucionet kosovare, pothuajse të gjithë të anketuarit deklarojnë se nuk informohen për konkurset për vende pune dhe se nuk e dinë se ku publikohen shpalljet, çka konfirmon mungesën e interesimit për ofertën e punës në sektorin publik të Kosovës.

Përveç mungesës së shprehur të interesimit personal, të anketuarit theksojnë se as në mesin e bashkëmoshatarëve të tyre dhe në rrethin e ngushtë nuk ekziston ndonjë interes i dukshëm për punë në institucionet kosovare. Rrallë ndonjë prej të njohurve të tyre e konsideron këtë opcion, aplikon apo punon në institucionet kosovare. Përrjashtim nga kjo mospërfillje e përgjithshme përbëjnë disa profesione, p.sh. juristët. Të anketuarit pohojnë se juristët shprehin interesim për karrierë në sistemin gjyqësor dhe në institucionet e pavarura, ku e shohin potencialin për zhvillim profesional dhe ndikim më të vogël politik në punën e përditshme. Për këtë arsye, ata janë më të interesuar se mesatarja për punë në institucionet kosovare krahasuar me profesionet e tjera.

Nga numri i përgjithshëm i të anketuarve, vetëm njëri aktualisht punon në institucionet kosovare, njëri ka punuar më parë por e ka lënë punën, një ka aplikuar dhe është refuzuar për shkak të problemit me diplomën, ndërsa një tjetër është në pritje të rezultatit të aplikimit. Të gjithë të tjerët asnjëherë nuk kanë aplikuar për punë në ndonjë institucion të Kosovës, ndërsa një numër i madh prej tyre nuk janë informuar asnjëherë për një mundësi të tillë. Megjithatë, disa prej tyre shprehin se do të ishin të gatshëm të shqyrtonin punën në institucionet kosovare si opcion në rast se nuk do të gjenin punë në institucionet serbe apo diku tjetër. Këtë e përmendin veçanërisht ata që janë të vendosur të qëndrojnë në Kosovë. Për ta, puna në institucionet kosovare përfaqëson një mundësi rezervë, të pranueshme nëse mungojnë opsionet e tjera.

# Komuna si asociacioni kryesor për institucionet e Kosovës

Kur flasin për institucionet e Kosovës, pothuajse të gjithë të anketuarit i mendojnë kryesisht ato në nivel lokal, pra komunat. Puna në komuna shihet si potencialisht e pranueshme, por në këtë drejtim shprehen dallime të mëdha rajonale. Institucionet qendrore (ministrinë, agjencitë, trupat e pavarura etj.) rrallëherë shihen si opcion për punësim. Këto institucione zakonisht perceptohen si të largëta fizikisht dhe politikisht, si dhe të paarrtshme.

Për shumicën e të anketuarve, veçanërisht ata që jetojnë në veri të Kosovës, institucionet me seli në Prishtinë nuk perceptohen si adresa reale apo e dëshirueshme për të kërkuar punë. Arsyeja për këtë nuk ka të bëjë vetëm me distancën politike, por edhe me paarrtshmërinë praktike të tyre. Pagat në institucionet e Kosovës konsiderohen aq të ulëta sa që të punësuarve që do të udhëtonin nga mjediset serbe nuk do t'u mbetej një pjesë e mjaftueshme e të ardhurave pas mbulimit të shpenzimeve bazë ditore, si transporti për në Prishtinë dhe ushqimi. Për këtë arsye, shumë të anketuar e vlerësojnë punën në ndonjë institucion në Prishtinë si financiarisht të paarsyeshme. Në këtë kontekst, vetëm të anketuarit nga Graçanica theksojnë se do ta merrnin parasysh mundësinë për të kërkuar punë në Prishtinë.

## Konteksti lokal si faktor përcaktues

Dallimet mes vendbanimeve, përkatësisht veriut dhe jugut të Kosovës, ndikojnë ndjeshëm në qëndrimet e të anketuarve ndaj punësimit në institucionet e Kosovës.

Qëndrimet e të rinjve në veri të Kosovës janë formësuar nga rrethanat politike që pasuan pas tërheqjes së përfaqësuesve serb nga institucionet e Kosovës në fund të vitit 2022. Në një atmosferë ku komunat udhëhiqen nga zyrtarë shqiptarë dhe ku shumë ndërtesa të institucioneve janë marrë nën praninë e njërive policore, ideja për të punuar në institucionet e Kosovës duket e paimagjinueshme. Shumë të anketuar shprehin ndjenjën e të qenit të përjashtuar dhe të mospranuar nga ato institucione.



Të anketuarit nga veriu i Kosovës theksojnë se punësimi në komunat që aktualisht udhëhiqen nga përfaqësues shqiptarë do të haste në mospëlqim dhe dënim brenda komunitetit, pasi kjo do të perceptohej si shenjë bashkëpunimi me strukturat aktuale të pushtetit që janë vendosur pa pajtimin e popullatës lokale. Rezistencë të veçantë shkakton mënyra se si janë hapur institucionet e reja. Këtë e dëshmojnë edhe fjalët që të anketuarit përdorin, duke theksuar se ato janë vendosur pa marrëveshje paraprake, “me dhunë” dhe me “mbylljen e institucioneve serbe”, gjë që prodhon ndjesinë se këto struktura janë “të imponuara” ndaj komunitetit.

Të rinjtë që jetojnë në veri të Kosovës shpesh zgjedhin të punojnë në institucionet serbe ose planifikojnë të largohen, ndërsa puna në strukturat kosovare, përfshirë edhe komunat, nuk shihet aspak si mundësi. Përveç kësaj, shumë prej tyre ndihen të pasigurtë për shkak të reagimeve të mundshme negative nga komuniteti dhe humbjes së përfitimeve ekzistuese. Nga ana tjetër, ekziston një ndjenjë e theksuar e përkohshmërisë së situatës aktuale. Të anketuarit nga veriu i Kosovës shpesh shprehen se presin ndryshime pas zgjedhjeve lokale në vjeshtën e vitit 2025, kur komunat pritet t'i rikthehen përfaqësuesve serb. Në atë rast, ata besojnë se shumë më tepër njerëz do të jenë të gatshëm të aplikojnë për konkurse, ashtu siç ka qenë rasti edhe më parë, kur komunat udhëhiqeshin nga kuadrot serbe.

Në komunat me shumicë serbe në jug të lbrtit, veçanërisht në Graçanicë dhe rrethinë, vërehet një qëndrim më pragmatik ndaj institucioneve të Kosovës. Për këto institucione flitet më shpesh në terma ekonomik, si p.sh. pagat dhe leverdia e punësimit. Edhe pse sistemi serb ende ka përparësi për shkak të pagave më të larta dhe sigurimeve më të gjera shoqërore, të rinjtë nga këto zona më shpesh shprehen se do të ishin të gatshëm të shqyrtonin punën në institucionet e Kosovës, sidomos në situatat kur nuk kanë qasje në punësim brenda strukturave serbe. Po ashtu, ata shprehin një shkallë më të lartë besimi se do të trajtoheshin me korrektësi në institucionet qendrore që udhëhiqen nga shqiptarët, kryesisht sepse ekziston një obligim ligjor për punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë.

Nga ana tjetër, të rinjtë nga fshatrat serbe që ndodhen në komuna me shumicë shqiptare, si Gorazhdeci (Pejë), Ropotovë e Madhe (Kamenicë) dhe Prilluzha (Vushtrri), rrallëherë e konsiderojnë punën në strukturat lokale komunale. Ata ndihen të rezervuar, të distancuar dhe shprehin mungesë besimi në mundësinë e integritit dhe përparimit real në një ambient të tillë pune.

# Ndërmjet tensioneve politike aktuale dhe nevojave ekzistenciale

Korniza dominuese në të cilën të anketuarit mendojnë për punësimin në institucionet e Kosovës është situata politike aktuale. Të gjithë të anketuarit flasin nga një pozitë e formësuar thellësisht nga tensionet aktuale midis autoriteteve të Kosovës dhe komunitetit serb. Kjo dëshmon se qëndrimi ndaj punësimit në institucionet e Kosovës nuk është vetëm rezultat i reflektimit mbi mundësitë profesionale, por është i kushtëzuar nga perceptimi i zhvillimeve të tanishme politike. Në këtë kontekst, institucionet e Kosovës nga shumë të anketuar nuk perceptohen si vende potenciale të punësimit, por si burim rreziku dhe pasigurie. Përjashtim deri diku përbëjnë strukturat komunale në komunat me shumicë serbe në jug të lbrit.

Pothuajse të gjithë të anketuarit shfaqin një distancë të theksuar ndaj institucioneve të Kosovës. Shumica e përgjigjeve që japin të anketuarit nuk mbështeten në shqyrtimin e skenarëve të ardhshëm më pozitiv, por komentet e tyre janë tërësisht të rrënjësura në të tashmen, me ndjesi të qarta pasigurie dhe tensioni. Qysh në përzgjedhjen e fjalëve që përdorin, vërehet mungesë besimi dhe distancim. Përdoren shpesh shprehje si *“frikë”, “me dhunë”, “diskriminim”* dhe *“nuk ka perspektivë”*. Përdoren terma si *“sistemi i tyre”* apo *“ligjet e tyre”*. Ky diskurs tregon jo vetëm një rezervim politik, por edhe një ndjenjë të thellë përjashtimi nga proceset vendimmarrëse dhe mosbesim ndaj institucioneve. Në këtë frymë, njëri nga të anketuarit thekson se nuk dëshiron të jetë *“një dekor simbolik”*.

Përveç perceptimit të zhvillimeve politike më të gjera, qëndrimet e të anketuarve formësohen edhe nga vlerësimi ekonomik dhe profesional i institucioneve të Kosovës. Shumë prej tyre theksojnë se pagat në institucionet kosovare janë të ulëta në krahasim me sistemin serb. Për më tepër, për ata që do të duhej të udhëtonin deri në vendin e punës, shpenzimet e transportit shpesh e bëjnë të pakuptimtë pagën. Kjo forcon përshtypjen se puna në institucionet e Kosovës *“nuk i’a vlen”*, jo vetëm politikisht, por as financiarisht. Gjatë bisedave, ky aspekt përmendet shpesh si arsyeja kryesore pse nuk mendohet për kërkimin e një vendi pune në institucionet qendrore me seli në Prishtinë.

Të anketuarit thonë se edhe ata persona nga rrethi i tyre që janë të punësuar në institucionet kosovare e shohin shpesh këtë si një zgjidhje të përkohshme. Për ta, kjo është *“nevojë, jo zgjidhje”*. Të anketuarit nuk e konsiderojnë sistemin kosovar si një mjedis që ofron mundësi për avancim ose zhvillim profesional, përveç ndoshta për disa profesione të specializuara. Për më tepër, asnjëri nga të anketuarit nuk ka shprehur interesim për programe rikualifikimi me qëllim të gjetjes së punës në institucionet kosovare.

# Pengesat procedurale dhe perceptimi i diskriminimit

Shumë të anketuar theksojnë një sërë pengesash administrative dhe procedurale që e vështirësojnë më tej punësimin në institucionet e Kosovës. Si problemet kryesore përmenden mungesa e informacionit në gjuhën serbe, mungesa e transparencës në konkurse dhe praktika jo e njëtrajtshme e njohjes së diplomave. Edhe pse shumica nuk i konsiderojnë këto pengesa si të pakapërcyeshme, ato ndikojnë negativisht në motivimin e të rinjve që, edhe ashtu, nuk tregojnë ndonjë interes të madh.

Është vërejtur një dallim i qartë në perceptimin e institucioneve, varësisht nga fakti nëse ato udhëhiqen nga serb apo shqiptarë. Për institucionet që drejtohen nga serbët, siç janë vetëqeverisjet lokale në mjediset në jug të lbrit, ekziston bindja e përhapur se punësimi ndodh kryesisht përmes lidhjeve politike, partiake dhe familjare, gjë që dekurajon shumë të rinj që nuk e shohin veten si konkurrentë të barabartë pa "lidhje". Nga ana tjetër, kur bëhet fjalë për institucionet që udhëhiqen nga shqiptarët, të anketuarit tregojnë një vetëdije më të madhe për ekzistencën e kuotave apo nevojës për të punësuar serb, prandaj besojnë se kanë objektivisht më shumë gjasa për t'u punësuar. Megjithatë, në këto raste, në plan të parë dalin problemet me barrierën gjuhësore dhe njohjen e diplomave.

Kur është fjala për verifikimin e diplomave, përvojat janë të ndryshme. Disa të anketuar thonë se procedura kryhet pa vështirësi të mëdha, ndërsa të tjerë përmendin raste kur verifikimi ka zgjatur shumë ose ka qenë i pamundur për shkak se komisioni kompetent nuk ka funksionuar.

Frika nga diskriminimi etnik është e pranishme tek disa të anketuar, veçanërisht kur flitet për punën në mjedisë ku ata, si serb, do të ishin të vetmit në kolektivin e punës. Të anketuarit mendojnë se në një ambient të tillë do të ndiheshin të izoluar dhe të padëshiruar. Nga ana tjetër, disa të anketuar shprehin gatishmëri për të punuar në një mjedis me shumicë shqiptarë. Kjo qasje bazohet në një logjikë racionale dhe pragmatike: nëse kushtet e punës janë të mira, nëse ka nevojë të theksuar për staf serb dhe nëse konkursi është i hapur dhe transparent, disa prej tyre do të shqyrtonin edhe mundësinë e punësimit në institucionet e udhëhequra nga shqiptarët.

# Ndikimi i komunitetit

Çështja e perceptimit të komunitetit luan një rol të rëndësishëm në mendimet e të rinjve lidhur me punësimin në institucionet e Kosovës. Shumë të anketuar shprehën se, në rrethanat aktuale, angazhimi në institucionet e Kosovës nuk do të ishte i drejtë apo i pranueshëm. Kjo ndjesi personale përforcohet nga reagimet e pritura nga mjedisi. Aplikimi për një vend pune në institucionet e Kosovës perceptohet si i papërshtatshëm ose i padëshirueshëm, pasi ekziston frika se kjo mund të shkaktojë komente, keqkuptime ose distancim nga komuniteti. Ky shqetësim nuk është domosdoshmërisht rezultat i presioneve të drejtpërdrejta, por më shumë pasqyron një atmosferë të përgjithshme rezervimi ndaj institucioneve të Kosovës brenda komunitetit serb.

Një ndjenjë e tillë e kujdesit është e nxitur më tej nga rrethanat politike aktuale, ku komunitat në veri udhëhiqen nga zyrtarët shqiptarë dhe institucionet qendrore në Prishtinë perceptohen si përgjegjëse për veprime të njëanshme në mjediset serbe. Në këtë kontekst, angazhimi në institucionet e Kosovës shpesh shihet si një veprim që nuk është në përputhje me pritshmëritë aktuale të rrethit. Edhe në mjediset në jug të lbricit, ku ekziston një qasje më pragmatike dhe shkallë më e ulët rezervimi, nuk vërehet ndonjë entuziazëm i theksuar. Mundësia për punësim në sistemin kosovar shqyrtohet kryesisht nga nevoja dhe jo si një zgjedhje e dëshirueshme për karrierë.

Njëkohësisht, është i pranishëm edhe perceptimi se nga vetë komuniteti nuk kanë ardhur mesazhe të qarta inkurajuese se pjesëmarrja në institucionet e Kosovës është legjitime dhe e pranueshme. Madje edhe në mesin e atyre që nuk kanë ndonjë qëndrim politik kundërshtues, një qëndrim i tillë i mjedisit funksionon si një barrierë efektive. Disa të anketuar theksojnë se ndryshimi eventual i qëndrimit do të ishte i mundur vetëm nëse nga vetë komuniteti do të vinte një mesazh i qartë se përfshirja në punën e institucioneve kosovare është bërë e pranueshme.

## Heqja dorë dhe migrimi si përgjigjje

Së fundmi, një numër i konsiderueshëm të rinjsh nga komuniteti serb nuk e konsideron punësimin as në sistemin serb e as në atë kosovar, por planifikon largimin nga Kosova. Ndjenja dominuese e mungesës së perspektivës kontribuon në pasivizim, humbje motivimi dhe interesim gjithnjë e më të ulët për përfshirje në institucionet lokale, pavarësisht përkatësisë së tyre. Madje edhe ata që janë ende aktiv në kërkimin e një pune, zakonisht e bëjnë këtë me shpresën që të shërbejë si fazë kalimtare drejt largimit, e jo si hap drejt përfshirjes afatgjate në ndonjë kornizë institucionale apo integrimi në Kosovë.

## Vlerësime përfundimtare

Gjetjet e hulumtimit tregojnë se çështja e punësimit të rinjve serb në institucionet e Kosovës nuk mund të trajtohet e shkëputur nga konteksti më i gjerë politik dhe klima shoqërore në të cilën jetojnë të anketuarit. Pothuajse të gjithë pjesëmarrësit e bisedave i kanë shprehur qëndrimet e tyre nën ndikimin e fortë të tensioneve aktuale politike dhe krizës në marrëdhëniet midis komunitetit serb dhe institucioneve në Prishtinë. Në vend që punësimi të shihet si një sfidë profesionale apo mundësi për zhvillim, të rinjtë e perceptojnë atë kryesisht si një zgjedhje të ngarkuar politikisht dhe me rreziqe të mundshme për sigurinë.

Përveç arsyeve praktike në aspektin e të ardhurave dhe kushteve të punës, hulumtimi ka treguar se një pengesë e rëndësishme është mosbesimi i thellë ndaj institucioneve të Kosovës si tërësi. Shumë të anketuar thonë se këto institucione nuk i ndjejnë si **"të tyre"**, çka e zvogëlon më tej motivimin për të marrë në konsideratë ndonjë angazhim profesional brenda tyre. Edhe kur nuk ekzistojnë pengesa formale, siç janë njohja e diplomave apo gjuha, mungon ndjenja e perspektivës dhe sigurisë.

Perceptimi i të rinjve serb për institucionet e Kosovës ka një rol kyç në formësimin e qëndrimeve të tyre. Sipas tyre, punësimi në sistemin kosovar bart konotacion politik. Ai nuk perceptohet si një vendim neutral profesional, por si një akt që mund të interpretohet si largim nga pritjet dhe vlerat kolektive të komunitetit. Kjo peshë simbolike largon edhe ata që, në rrethana të tjera, ndoshta nuk do të kishin asgjë kundër të kërkonin punë në këto institucione.

Përveç domethënies politike, institucionet e Kosovës për shumicën e të anketuarve nuk janë as profesionalisht tërheqëse. Pagat perceptohen si të ulëta, mundësitë për avancim si të kufizuara, ndërsa ambienti i punës si i pasigurt dhe jo mjaftueshëm gjithëpërfshirës. Dimensionin hapësinor është gjithashtu i rëndësishëm. Për shumë të anketuar, vendndodhja e institucionit është thelbësore. Nëse puna kërkon udhëtim të përditshëm në një lokacion të largët, kjo shpesh e bën të pakuptimtë gjithë idenë e punësimit, sepse angazhimi bëhet jo i levërdhishëm.

Megjithatë, përkundër skepticizmit të theksuar, hulumtimi ka treguar se qëndrimet nuk janë homogjene. Këto gjetje tregojnë për ekzistencën e një gatishmërie të fshehur dhe potencial për hapje ndaj institucioneve të Kosovës – që ende nuk vie në pah për shkak të qëndrimit dominues të distancës dhe kujdesit brenda komunitetit. Disa të anketuar kanë shprehur hapur gatishmërinë për të punuar në institucionet e Kosovës, por kryesisht për arsye ekonomike – nevoja për të ardhura të qëndrueshme. Megjithatë, gatishmëria e tyre nuk është pa kushte. Për shumë prej tyre, parakushti thelbësor nuk është vetëm interesi personal, por edhe përcaktimi kolektiv i komunitetit për t'i dhënë një **"mundësi"** institucioneve kosovare. Nëse do të kishte mbështetje më të gjerë dhe konsensus brenda komunitetit që të shfrytëzohet hapësira e ofruar për punësim, edhe ata vetë do ta shqyrtonin këtë opcion.

## Rekomandimet



### **Depolitizimi i çështjes së punësimit në institucione**

Është e nevojshme të punohet në ndryshimin e perceptimit të rrënjosur se puna në institucionet e Kosovës nënkupton besnikëri politike apo distancim nga komuniteti. Përmes fushatave publike, dialogut me komunitetin dhe përfshirjes së shembujve pozitiv nga praktika, duhet ndërtuar një narrativë që e paraqet punësimin në institucione si një vendim profesional, legjitim, neutral dhe personal – e jo si një akt me ngarkesë politike. Punësimi duhet të komunikohet në kontekstin e nevojave ekonomike, profesionale dhe jetësore të individit, e jo si shprehje e orientimit politik. Në këtë mënyrë mund të reduktohet presioni shoqëror dhe të fuqizohen të rinjtë që të marrin vendime të pavarura për zhvillimin e tyre profesional.



### **Ndërtimi i imazhit të institucioneve të Kosovës si mjedis profesional dhe nxitës për të rinjtë**

Duhet promovuar në mënyrë aktive përparësitë e punës në sektorin publik – si stabiliteti i punësimit, mundësitë për zhvillim profesional dhe kontributi për komunitetin. Për të rritur atraktivitetin e këtyre vendeve të punës, është e domosdoshme përmirësimi i kushteve të punës, paraqitja më e qartë e përfitimeve që kanë në dispozicion të punësuarit, si dhe përshtatja e ofertës me nevojat e të rinjve nga mjedise të ndryshme. Rritja e dukshmërisë së këtyre përparësive mund të kontribuojë në interes më të madh të të rinjve dhe tërheqjen e kuadrove cilësore në institucionet e Kosovës.



### **Rritja e dukshmërisë dhe qasjes në informata për konkurset, veçanërisht në gjuhën serbe**

Duhet të punohet në përmirësimin e qasjes në informacionet për konkurset në mënyrë që të gjithë qytetarët, përfshirë edhe pjesëtarët e komunitetit serb, të kenë qasje të barabartë në shpalljet për punësim. Publikimi i rregullt i konkurseve në gjuhët e komuniteteve, në platforma të shënuara qartë dhe lehtësisht të qasshme, mund të kontribuojë në rritjen e dukshmërisë dhe të perceptimit të përfshirjes.

## **Nxitja e ndërtimit të besimit përmes kontaktit të drejtpërdrejtë dhe shembujve pozitiv**

Është e rëndësishme të përfshihen në mënyrë aktive të rinjtë që tashmë janë të punësuar në institucionet e Kosovës si ndërmjetës në komunikimin me bashkëmoshatarët e tyre. Dëshmitë e tyre personale për punën, kushtet dhe mundësitë profesionale mund të kontribuojnë në thyerjen e paragjykimeve dhe hapjen e hapësirës për një kuptim më realist dhe më pak të politizuar të përfshirjes në institucione.

## **Forcimi i mekanizmave lokal për mbështetjen e punësimit të të rinjve nga komunitetet joshumicë**

Duhet zhvilluar programe lokale të mbështetjes që do t'u ofronin informacione praktike të rinjve nga komunitetet joshumicë, këshillim dhe ndihmë në procesin e aplikimit për vende pune në institucionet e Kosovës. Përmes mbështetjes këshilluese, mund të ulet ndjenja e shkëputjes nga sistemi dhe të rriten gatishmëria dhe kapacitetet e të rinjve për të kërkuar punë në sektorin publik.

## **Adresimi i dimensionit hapësinor të qasjes në punësim**

Duke pasur parasysh se shumë vende pune janë fizikisht të largëta nga vendbanimet e pjesëtarëve të komunitetit serb, veçanërisht në veri të Kosovës, është e nevojshme të shqyrtohen masa që do të reduktonin pengesat logjistike për punësim. Këto masa përfshijnë: subvencionimin e transportit, decentralizimin e disa vendeve të punës dhe mundësimin e punës hibride aty ku është e mundur – në mënyrë që të rritet qasja dhe levërdia e angazhimit institucional.

